



VENDIM
Nr. 95 Datë 07.12.2010

PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KESH SH.A PËR PERUDHEN 1 JANAR – 31
DHJETOR 2011

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit Nr.77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Vendimit Nr.62, Datë 13.09.2010, të Bordit të Komisionereve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për vitin 2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2011 si dhe relacionin e Grupit të Punës të ERE-s,

Vendosi :

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do të jetë 0.63 leke/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.